

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9695, DATË 19.3.2007, ‘PËR PROCEDURAT E BIRËSIMIT DHE KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMIT’, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit’, të ndryshuar”, ka për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, konkretisht ndaj aplikantëve që kërkojnë të ndjekin procedurat e birësimit. Gjithashtu, ndërmjet këtij projektligji synohet ofrimi i praktikave më të mira me qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve të braktisur në Republikën e Shqipërisë dhe paralelisht për të siguruar një shërbim sa më cilësor në raport me kërkesat e personave të interesuar për birësimin e fëmijëve.

Për sa më sipër, Ministria e Drejtësisë, mbi bazën e propozimeve të Komitetit Shqiptar të Birësimeve ka përgatitur projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit’, të ndryshuar”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji i propozuar ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit’, të ndryshuar”, parashikon heqjen e dorëzimit të dokumentacionit nga aplikantët për birësim që lidhet me disa nga të dhënat për gjendjen civile, konkretisht me certifikatën e martesës, certifikatën e zgjidhjes së martesës ose të vdekjes së bashkëshortit, pasi këto dokumente do të përftohen nga vetë institucioni i KSHB-së, përmes aksesit si institucion në portalin e shërbimeve të integruara E- Albania.

Dokumentacioni do të përfitohet nga KSHB në momentin që do të pajiset me të drejtën për ta patur akses në sistemin përkatës me username dhe passwordin.

Gjithashtu, parashikohet heqja e dorëzimit të vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe heqja e paraqitjes së vërtetimit, nga organet e njësisë së qeverisjes vendore të vendbanimit, për sjelljen dhe figurën morale, me qëllim përshpejtimin e procedurave të birësimit.

Pika 4, e ligjit nr. 9695/2007, parashikon dorëzimin e vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe propozohet heqja e këtij dokumenti si detyrim për individin duke bërë të mundur që ky i fundit, të përftohet nga institucioni që e ofron shërbimin.

Pika 10, e ligjit nr. 9695/2007, propozohet të shfuqizohet, pasi parashikon paraqitjen e vërtetimit, nga organet e njësisë së qeverisjes vendore të vendbanimit, për sjelljen dhe figurën morale”.

Ndërkohë që, në kuadër të procesit të derregullimit, pas disa takimeve që janë zhvilluar mes institucioneve është sugjeruar që ky dokument të mos dorëzohet gjatë aplikimit nga ana e personave të interesuar.

Faktikisht, vërtetimi nga organet e njësisë së qeverisjes vendore të vendbanimit, për sjelljen dhe figurën morale, është një dokument që lëshohet pas procesit të verifikimit që ata kryejnë lidhur me vlerësimin dhe gjetjet që lidhen me aplikantët përsa i përket sjelljes dhe imazhit të tyre në komunitet.

Ky është një dokument që kërkon një verifikim paraprak dhe nuk mund të prodhohet elektronikisht për shpejtësi veprimi por, për marrjen e tij, mund të përdoret forma e dërgimit të shkresës zyrtare nga institucioni e cila do kërkojë kohën e nevojshme që të përcillet nga institucionet e qeverisjes vendore deri në marrjen e informacionit zyrtar shkresor të dërguar prej tyre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me rendin juridik të brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ndryshimin e nenit 18, të ligjit nr. 9695, datë 19.03.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” i ndryshuar. Konkretisht:

Pika 3, ndryshohet duke hequr dorëzimin e dokumentacionit nga aplikantët për birësim që lidhet me disa nga të dhënat për gjendjen civile, përkatësisht me certifikatën e martesës, certifikatën e zgjidhjes së martesës ose të vdekjes së bashkëshortit, pasi këto dokumente do të përftohen nga vetë institucioni i KSHB-së, përmes aksesit si institucion në portalin e shërbimeve të integruara E-Albania.

Dokumentacioni do të përfitohet nga KSHB në momentin që do të pajiset me të drejtën për të patur akses në sistemin përkatës me username dhe passwordin. Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit do të kërkohet vetëm kopje e dokumentit të identifikimit.

Pika 4 dhe 10, shfuqizohen, pasi edhe dokumentacioni i kërkuar në këto pika, do të sigurohet nga vetë KSHB.

Si rezultat i kryerjes së ndryshimeve të propozuara, synohet një lehtësim i mëtejshëm i shërbimit për qytetarët pranë Komitetit Shqiptar të Birësimit, pakësim i kostove që paguajnë qytetarët për marrjen e dokumenteve, si dhe reduktim i kohës në dorëzimin e dokumentave pranë KSHB-së.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij ligji Komiteti Shqiptar i Birësimeve.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Drejtësisë mbi bazën e propozimeve të paraqitura nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve, e nëpërmjet shkresës me nr. 565 prot., datë 14.12.2017.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SALIU)